



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28 Maj 2021

Nr. 372

**VENDIM**

- Objekt:** Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ndaj z. Florian Tahiri, kandidat për deputet për subjektin zgjedhor PD-AN.
- Kërkues:** Qendra Muzeore Durrës
- Ndaj:** Z. Florian Tahiri, kandidat për deputet për subjektin zgjedhor PD-AN.
- Baza Ligjore:** Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata,

**VËREN:**

**I**

**Vlerësimi paraprak**



Data: 28 Maj 2021  
Nr. 372

Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj z. Florian Tahiri, kandidat për deputet për subjektin zgjedhor PD-AN.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me shkresën nr. 122 prot., datë 02.04.2021, protokolluar pranë KQZ me shkresën nr. 3203 prot., datë 05.04.2021, në të cilën jemi informuar se z. Florian Tahiri, kandidat për deputet për subjektin zgjedhor “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, ka kryer fushatë në ambientet e brendshme të Muzeut Arkeologjike Durrës dhe të Amfiteatrit. Referuar denoncimit, Qendra Muzeore Durrës pretendon se, **“Ky spot i afishuar në rrjetet sociale, tregon se në brendësi të ambienteve është kryer fushatë. Ky aktivitet bie në kundërshtim me ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” ku në brendësi të këtyre ambienteve lejohen të zhvillohen vetëm aktivitete artistike apo aktivitete që shërbejnë për promovimin e trashëgimisë kulturore. Kjo bazuar në nenin 100 të këtij ligji, miratimi i çdo aktiviteti në objektet pasuri kulturore bëhet me miratim të ministrit përkatës.”**

Bashkëngjitur këtij denoncimi janë dërguar foto të kandidatit në këto ambiente.

Bazuar në nenin 8, pika 1, të vendimi nr. 9 datë 09.03.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve verifikoi se në denoncimin e paraqitur nuk kishte përcaktim të qartë të shkeljes së kërkuar nga denoncuesi dhe brenda 5 (pesë) ditëve, me shkresën nr. 3203 prot., datë 08.04.2021, i kërkoi specifikimin e kërkesës në lidhje me këto pretendime.

Qendra Muzeore Durrës, me shkresën nr. 122/2 prot., datë 09.04.2021, protokolluar pranë KQZ me shkresën nr. 3203/2 prot., datë 13.04.2021, ka kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë për shkeljen e pretenduar në denoncimin me shkresën nr. 122 prot., datë 02.04.2021, protokolluar pranë KQZ me shkresën nr. 3203 prot, datë 05.04.2021.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, **“Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi”**, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesën lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e saj dhe vlerësoi se nuk mund të shprehet për shkelje të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” pasi del jashtë kompetencës lëndore të tij.

Juridiksioni dhe kompetenca janë parakushte procedurale që duhet të plotësohen në mënyrë që të krijohet një marrëdhënie juridike procedurale e vlefshme.



Sipas përcaktimeve të nenit 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e **këtij ligji në mënyrë të drejtë**, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Përsa i përket postimit në llogarinë e kandidatit për deputet në Facebook, referuar vendimit nr. 4, datë 22.01.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, **ky postim nuk e bën veprimtarinë publike**. *“Postimi dhe veprimtaria janë dy ngjarje të dallueshme qartë nga njëra tjetra dhe të zhvendosura në kohë. Nga ana tjetër, Facebook-u apo media të tjera sociale nuk bëjnë pjesë në kategorinë “media” që kërkon pika 1 e nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Dispozita kërkon “pjesëmarrje” të medias, që t’a konsiderojë veprimtarinë publike”*. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se postimi në Facebook i spotit për fushatë, nuk përbën shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, pasi nuk ndodhemi para rastit të përdorjes së burimeve publike mbështetje të fushatës zgjedhore të z. Florian Tahiri.

Referuar pikës 2, të nenit 8, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, *“në rastet kur KQZ nuk është organi kompetent dhe/ose nëse mungojnë indiciet e besueshme për të nisur hetimin administrativ, Komisioneri vendos refuzimin për nisjen e hetimit administrativ”*.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se denoncimi nuk futet në kompetencën lëndore të tij dhe për këtë arsye nuk mund të nisë hetimin administrativ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit neneve 23 dhe 24 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9/2020 dhe vendimit nr.9/2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,



## V E N D O S:

1. Të shpallë moskompetencën lëndore të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtimin e kërkesës.
2. Të përcjellë menjëherë kërkesën për kompetencë, Ministrisë së Kulturës, si organ publik, kompetent për ta shqyrtuar këtë kërkesë.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 28 Maj 2021  
Nr. 372

Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj z. Florian Tahiri, kandidat për deputet për subjektin zgjedhor PD-AN.